



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Projekt-Vendim - NR. 5

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të kërkesave të bëra nga familjet e mëposhtme dhe verifikimeve të bëra nga punonjesis socialë të Njësi Administrative të Bashkisë Maliq për gjëndjen social-ekonomike për familjet e mëposhtme i kërkojmë Këshillit të Bashkisë

I. Miratim fondi për familjen e mëposhtme:

Nr	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Arben Hardi	G20905150J	Maliq	50 000
2	Illirjan Kellezi	H10620311V	Maliq	20 000
3	Hyrie Cenolli	G65527039M	Libonik	30 000
				100 000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2024, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	100 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Pranoi: Pergj. Sekt.Sherimit Social  
Miratoi:Dr.Finances dhe Buxhetit  
Jurist:

(EmërMbiemër)

E.Petriti  
A.Muka  
J.Thomo

Nënshkrimi

Data

Dt.24.06.2024  
Dt 24.06.2024  
Dt 24.06.2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

SEKTOR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 20.06.2024

**Relacion**

**Për "Dhënie e Ndhmës Financiare për familjet në nevojë"**

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndhmës Ekonomike Maliq, të Njësisë të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

**1. Z. Arben Hadri**

Familja e Z ,Arben Hadri banues të qytetit Maliq, Bashkia Maliq, jeton ne kushte shumë të vështira ekonomike. Të ardhurat e vetme të familjes sigurohen nga puna në të zezë e kryefamiljarit dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të vajzës së tij. Ai jeton vetëm me bashkëshorten dhe 3 fëmijët e tyre ku njëra nga vajzat R. Hadri vuan nga hemiplegji sinister, epilepsy, probleme te shëndetit mendor si dhe diagnoza te tjera bashkëshoqëruese. Bashkëshortja nuk mund të punojë pasi duhet të kujdeset për vajzën për shkak të problemeve shëndetësore. Duke qënë se familja ka vetëm kryefamiljarin në gjendje për të punuar e ka të pamundur për të përballuar shenzimet për mjekimin e vajzës e cila duhet ti nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale, për këtë arsye kërkon një ndihmë financiare.

**2. Z. Ilirjan Kellezi**

Familja e Z ,Ilirjan Kellezi banues të qytetit Maliq, Bashkia Maliq, jeton ne kushte shumë të vështira ekonomike. Të ardhurat e vetme të familjes sigurohen nga puna në të zezë e kryefamiljarit. Ai jeton vetëm me bashkëshorten dhe 2 fëmijët e tyre në një banesë në kushte të vështira ekonomike. Pamundësisë së sigrimit të një pune të qëndrueshme i shtohen edhe problemet shëndetësore që ilirjani ka pasur kohët e fundit. Duke qene se kryerja e analizave dhe ndërhyrjes ka kosto të lartë dhe familja ka pasur vështirësi në sigurimin e një pune është e nevojëshme mbështetja e kësaj familje me një ndihmë financiare.

**3. Hyrie Cenolli**

Znj.Hyrie Samit Cenolli është banore e fshatit Vashtemi, Nj Adm.Libonik . Znj .Hyrije është gjendje jo të mirë shëndetsore pasi vuan nga një sëmundje e rëndë me melanoma, CA, dhe ka kryer disa operacione .Gjendja e saj është shumë e rënduar .Trajtimet që z.Hyrie duhet të marrë janë shumë të kushtueshme dhe të ardhurat që ka familja janë të papërbalueshme. Hyria jeton me bashkëshortin dhe me vajzen e saj te divorcuar me dy fëmijë dhe djali i cili është i papunë. E vetmja e ardhur e familjes sigurohen nga puna në të zezë ku kanë mundësi .

Duke parë gjendjen e familjes dhe të zonjës në vecanti është e nevojëshme mbështetja me ndihmë financiare nga Këshilli i Bashkisë.

Pranoi: Pergj. Sekt.Sherimit Social

E.Petriti

Dt.24.06.2024

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

